



C.nr.657/14

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] [REDACTED], të cilën e përfaqëson [REDACTED] me autorizim, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 2.055,96 €, pas seancës publike të mbajtur më 12.04.2016, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të paditurit mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesë padia e paditëses, [REDACTED] e paraqitur kundër të paditurit [REDACTED], nga Ferizaj Rr. [REDACTED], si e bazuar


**II. DETYROHET** i padituri që paditëses të i paguaj shumën prej 2,055.96 €, (dymijë e pesëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent.), si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 40 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë si dhe precizimit të kërkesë padisë duke shtuar se nga provat e administruara u vërtetua se i padituri ia ka borxh paditës shumën e precizuar, ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë ta aprovon si të bazuar.

I Ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese.

Nga fletkthesa e ardhur shihet se ftesa të pranuarit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e kanë arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar andaj gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit, në kuptim të 423.4 të LPK-së.



Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: U lexua padia e paditëses C.nr.657/14 e dt.02.10.2014, marrëveshja kreditore me nr.1780/1/Fe e dt.24.12.2011, e lidhur në mes paditësit dhe të paditurit, pasqyra e obligimeve të arritura për kredi dt.23.09.2014, kontrata e marrëdhënies së punës e lidhur në mes paditëses dhe të paditurit, aneks kontrata e punës me nr.1192 e dt.01.09.2010, vendimi për lejimin e kredisë nr.1780/1/Fe e dt.24.11.2011 autorizimi i paditëses dhënë të autorizuarit [REDACTED]

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar.

Nga provat e administruara u vërtetua se të paditurit kanë lidhur kontratë për marrjen e kredisë me paditësen në shumë prej 1.800€, të cilën shumë nuk ka prova se i padituri e ka paguar, e cila vërtetohet me faktin se të paditurit me paditësen janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete sipas nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 lidhur me nenin 1065 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara kontrata e kredisë.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 20 € dhe aktgjykim prej, 20 €, gjithsej në lartësi prej 40 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.657/14 më dt.12.04.2014

Gjyqtari  
Alban Beqiri



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

